

Bazuar në Urdhërin Nr. 105 Prot., datë 06.01.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin:

Drejtor, DRSSH Berat.

- Kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit “Master i Shkencave”, ose të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të Arsimit të lartë, në Shkenca ekonomike, juridike, administrim publik, Shkenca sociale;
- Të ketë të paktën 7 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike dhe/ose në një nivel të lartë menaxhimi në institucione private;
- Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vjet në nivel përgjegjës sektori brenda administratës së sigurimeve shoqërore, si dhe/ose jo më pak se 2 vjet në administratë publike/shërbim civil të një kategorie të barazvlefshme me kategorinë e drejtorit të drejtorisë apo me kategorinë e përgjegjës të sektorit, ose në sektorin privat në nivel të lartë menaxhimi, në nivel përgjegjësi apo drejtuesi.

#### **KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike që nuk është shënuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM & INTERVISTA**

Kandidatët do të testohen në lidhje me njohuritë:

- Në fushën e sigurimeve shoqërore (statusi i ISSH-së, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare, personelit dhe për sistemin e informacionit të ISSH-së;
- Të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";
- Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligjit nr .9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike;
- Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

## **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;

c) intervista me gojë, ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkurohet.

Totali i pikëve të vlerësimin të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, deri në 40 pikë;

b) për intervistën me gojë, deri në 60 pikë.

Kandidati konkuroes kualifikohet nëse në total ka fituar mbi 70 pikë, nga 100 pikë të mundshme.

## **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidati që aplikon duhet të dorëzojë dokumentat në zyrën e protokollit të ISSH-së, si më poshtë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin është i interesuar;

Një kopje të jetëshkrimit (CV);

- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);

- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

- Raport i aftësisë për punë;

- Fotokopje të librezës së punës;

- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;

- Fotokopje të kartës së identitetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 21/01/2021 pranë zyrës së prokoll /sekretarisë në ISSH.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e ISSH-së në datën 25.01.2021, ora 09.00.